



KONTRATË MBI QIRANË

E lidhur në Deçan me dt. 17 gusht 2023, në mes të palëve:

1. Komunës së Deçanit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj, në njërën anë, në tekstin vijues qiramarrësi.
dhe
2. Znj. Mandushe Mazrekaj nga Deçani, me nr. Personal [REDACTED] nga ana tjetër, në tekstin vijues qiradhënësi.

OBJEKTI I KONTRATËS

Neni 1.

Objekt i kësaj kontrate është dhënia, gjegjësisht marrja me qira e banesës e cila gjendet në qytetin e Deçanit, rrugës [REDACTED] me sipërfaqe 100 m², pronar i së cilës është znj. Mandushe Mazrekaj nga Deçani dhe ia jep me qira qiramarrësit Komuna e Deçanit të cilën e përfaqëson, kryetari z. Bashkim Ramosaj, me qira mujore prej 200 € në muaj, për 6 muaj radhazi dhe atë duke filluar nga data 17 gusht 2023 deri me dt. 17 shkurt 2024. Banesë e cila merret me qira për nevojat e strehimit të familjes së [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna e Deçanit me nr.personal [REDACTED], bashkë me [REDACTED] fëmijë të mitur si rast i rëndë social.

OBLIGIMET E KOMUNËS

Neni 2.

Qiramarrësi - Komuna e Deçanit sipas kësaj kontrate ka për obligim:


- Që nga buxheti komunal të paguaj nga 200 € për çdo fund të muajit, në emër të qirasë mujore. Sipas marrëveshjes paraprake qiraja do të paguhet në emër të znj. Mandushe Mazrekaj nga Deçani, me numër personal [REDACTED] në xhirollogarinë me nr. [REDACTED] në NLB Banka.

OBLIGIMET E QIRADHËNËSIT

Neni 3.

Qiradhënësi – Mandushe Mazrekaj nga Komuna e Deçanit ka për obligim:

- Të ja jep me qira banesën e gjendet rrugës së Gjimnazit në Deçan, me sipërfaqe 100m², e cila banesë është pronë private e saj dhe ia jep me qira Komunës së Deçanit të cilën e përfaqëson kryetari, z.Bashkim Ramosaj, me qira mujore prej 200 euro në muaj dhe atë prej datës 17 gusht 2023 deri me dt. 17 shkurt 2024, për nevoja të strehimit të familjes së [REDACTED], nga fshati [REDACTED], Komuna e Deçanit si rast i rëndë social.



OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

Neni 4.

Palët e kësaj Kontrate duhet të angazhohen që të gjitha obligimet e përcaktuara në këtë Kontratë t'i zbatojnë me përpikëri, meqenëse kontrata është shprehje e lirë e vullnetit të palëve kontraktuese.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 5.

Komuna do të kryej obligimet financiare që dalin nga kjo kontratë për çdo muaj, deri me dt.05 të muajit vijues do të bëhet pagesa për muajin paraprak.

Neni 6.

Kjo kontratë shkëputet me realizimin përfundimtar të saj, mirëpo mund të shkëputet edhe para afatit nëse palët nuk u përmbahen obligimeve që dalin nga kjo kontratë.

Neni 7.

Në rast të mosmarrëveshjeve eventuale palët do të përpiqen që të njëjtat t'i zgjedhin përmes bisedimeve të ndërsjella. Në rast se palët nuk arrijnë që mosmarrëveshjet të zgjedhin me mirëbesim, atëherë për zgjidhjen e kontestit kompetent është Gjykata Themelore Pejë-Dega në Deçan.

Neni 8.

Kjo Kontratë është e hartuar në 3 kopje origjinale identike, prej të cilave nga një e marrin palët kontraktuese, kurse me kopjet tjera do të paisen organet kompetente.

Neni 9.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

E nënshkruar në Deçan, me dt. 17 gusht 2023.

Palët nënshkruese të Kontratës:

Qiramarrësi:

Komuna e Deçanit

Kryetari: Bashkim RAMOSAJ



Qiradhënësi:

Mandushe Mazrekaj

